



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**KONCEPT DOKUMENTI PËR ÇËSHTJEN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË
TË PAJUSTIFIKUESHME¹**

Kapitulli 1: Hyrje

Hartimi i koncept dokumentit për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme është përfshirë në kuadër të *Listës së Koncept Dokumenteve për vitin 2015*. Rregullimi i kësaj fushe ndërlidhet me *Prioritetin Strategjik nr. 2 Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës*.

Në kuadër të Planit Zhvillimor Strategjik për vitin 2012 - 2016 të Ministrisë së Drejtësisë, në objektivin e parë është përcaktuar avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri ligjore me prioritetet që dalin nga procesi i integritimit evropian.

Kosova tashmë dihet se në fushën e sekuestrimeve dhe konfiskimeve gjendet në situatë jo të volitshme dhe kjo është kështu ngase vetëm në vitin 2014 kemi pasur një rritje, edhe atë vetëm sa i përket sekuestrimeve kurse vitet e mëparshme janë në vlerat më të vogla sa i përket qoftë sekuestrimit qoftë konfiskimit të dobisë pasurore të kundërligjshme, poashtu në mënyrë të vazhdueshme në Raportet e Progresit të KE-së theksohet se vlera e vogël e pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara.

¹ Komentet dhe propozimet lidhur me koncept dokumentin për fushën e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme mund të dërgohen në e-mail adresën: ardian.bajraktarai@rks-gov.net. Afati përfundimtar i dorëzimit të komenteve me shkrim në kuadër të procesit të konsultimit publik, është deri më 15.06.2015. Të gjitha komentet e pranuar brenda afatit do të shqyrtohen.

Poashtu, trendi botëror i ndjekjes së kryesve të veprave penale nënvizon faktin se tashmë është jashtëzakonisht e rëndësishme që fokusi i organeve të ndjekjes të mos jetë vetëm dënimi penal por edhe marrja e pasurive të kundërligjshme dhe se asgjë më shumë sesa konfiskimi nuk ka efekt mbi të pandehurin. Duke qenë se jemi vetëm në fillimin e luftës kundër këtij fenomeni dhe duke pasur parasysh faktin se Kosova gjendet e renditur shumë ulët në raportet e organeve prestigjioze ndërkombëtare, është më së e nevojshme që edhe Kosova ashtu sikurse edhe shumë vende tjera të ketë Ligjin Anti Mafia apo thënë më mirë ligjin që lejon konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme edhe pa një dënim penal.

Prioritet i institucioneve të Kosovës është avancimi i legjislacionit në fushën e ndjekjes së kryesve të veprave penale dhe në veçanti në fushën e konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale. Duke pasur parasysh që aktualisht Kosova është duke kaluar nëpër fazat e para-aderimit në BE, respektivisht është duke u hartuar Plani Kombëtar për Adoptimin e *Acquis* paraqitet domosdoshmëria në përafrimin/harmonizimin e legjislacionit vendor lidhur me përputhshmërinë me Direktivën nr. 2014/42 / BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e dt. 3 prill 2014 në ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave në BE duke siguruar koherencë me Ligjin për konfliktin e interesave me kornizën ligjore vendase dhe *acquis* të BE-së.

Kjo çështje ndërlidhet me prioritetet e qeverisë ngase sundimi i ligjit është një prej objektivave kryesore, pasi që vetëm luftimi i krimit sipas legjislacionin aktual më nuk është i mjaftueshëm. Prandaj tani konsiderohet se luftimi i krimit bëhet në formën më të plotë vetëm nëse kryesve u konfiskohet edhe pasuria të cilën e kanë krijuar në mënyrë të kundërligjshme.

Poashtu në kuadër të dokumenteve strategjike të Qeverisë, theksohet se qeveria do të garantoj më tepër siguri për investime nëse krijon një shtet ku mbisundon rendi dhe ligji dhe investuesit do të ndjenë veten më të lirë për të investuar në një vend të tillë.

Në vazhdimësi Qeveria është zotuar për sundim të rendit dhe ligjit dhe në luftimin e krimit ekonomik e korrupsionit ashtu sikurse edhe në luftimin e të gjitha krimeve tjera që gjenerojnë përfitime pasurore.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Infrastruktura ekzistuese ligjore, përfshirë Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK), Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale (LKZKPPVP) të aprovuara në fillim të vitit 2013 deri më tani nuk kanë dhënë rezultatet e pritura deri më tani andaj rezulton si e domosdoshme që të aprovohen edhe ligji që lejon konfiskimin e pasurisë së fituar me aktivitet kriminal edhe pa aktgjykim dënues.

Infrastruktura ekzistuese ligjore lejon konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, duke pasur si shënjestra vetëm personat ndaj të cilëve ka një aktgjykim dënues përderisa ligji që do të propozohet lejon zgjerimin e shënjestrave ngase lejohet konfiskimi i dobisë pasurore edhe pa pasur aktgjykim dënues. Poashtu ndikimi ka të bëjë edhe më faktin se ka efekt parandalues ndaj të gjithë atyre që mund të aplikohet ky ligj. Me këtë politikë është i prekur tërë territori i Republikës së Kosovës, ndërsa institucionet të cilat do të kenë të bëjnë në mënyrë direkte më këtë çështje janë: Prokuroria e Shtetit, KGJK-Gjykatat, MD-AAPSK, Policia e Kosovës, poashtu duke përfshirë edhe organizatat tjera zbatuese të ligjit që në një mënyrë mund të kenë të bëjnë me këtë ligj.

Përmasat dhe Kohëzgjatja e Problemit/Zotimit					
	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
Numri i njerëzve / incidenteve /organizatave					

Informata

Legjislacioni aktual parasheh se mund të behët konfiskimi i pasurisë së kundërligjshme për veprat penale të parapara në KPRK, mirëpo ky konfiskim mund te behet vetëm kur vërtetohet përgjegjësia penale, pra që nënkupton aktgjykimin dënues ndaj atij të pandehuri, poashtu LKZKPPVP përcakton që vetëm pesë kapituj të KPRK-së *sikurse janë: veprat penale kundër njerëzimit, krimin të organizuar, krimeve ekonomike, narkotikëve si dhe detyrës zyrtare apo korrupsionit*, parashihet që pjesërisht barra e të provuarit bie mbi të pandehurin, por një pjesë e madhe e të provuarit mbetet tek Prokurori dhe kjo përbën një problem të theksuar duke vështirësuar punën e organeve të ndjekjes përderisa politika që do të propozohet adreson këtë situatë dhe kjo duke u

bazuar në përvojën dhe praktikën e vendeve tjera që kanë pasur vështirësi të ngjashme ngase me politikën e re barra e të provuarit do të zhvendoset në masë më të madhe tek i pandehuri dhe kjo do ta lehtësoj në masë të madhe punën e prokurorisë dhe do ta evitoj në masë të madhe problemin që shfaqet aktualisht.

Me përjashtim aktgjykimi dënues nuk kërkohet për dy raste te konfiskimit sipas LKZKPPVP dhe ato raste janë: procedura e konfiskimit ndaj te pandehurit qe ka vdekur dhe ndaj te pandehurit që është arratisur.

Politika aktuale

Aktualisht Kosova ka një sistem që bazon konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme në bazë të një aktgjykimi dënues, madje sipas LKZKPPVP, vetëm për 5 kapitujt e KPRK-së sikurse janë: veprat penale kundër njerëzimit, krimit të organizuar, krimeve ekonomike, narkotikëve si dhe detyrës zyrtare apo korrupsionit.

Secili institucion zbatues i ligjit ka përgjegjësinë e tij në zinxhirin e hallkave të sistemit juridik dhe ky sistem funksionon si një tërësi dhe nëse dështon cilado hallkë e ndonjërit institucion atëherë mundësia për sukses në konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme zbehet në masë të madhe. Andaj institucionet kyçe janë: Policia e Kosovës, Prokurori i Shtetit, institucionet tjera zbatuese të ligjit, gjykatat etj.

Policia e Kosovës: bën ndjekjen e kryesve të veprave penale, identifikimin dhe mbledhjen e provave, hetimin financiar, identifikimin, gjurmimin dhe sekuestrimin e aseteve si dhe zbaton hetimin nën udhëheqjen e prokurorisë.

Prokuroria është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë së kundërligjshme, kufizimin e përkohshëm të pasurisë, kërkesa për urdhër për sekuestrim të përkohshëm, ngrirja e përkohshme e pasurisë, kërkesa për urdhër ndalues, kërkesa për masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, përfshirja e pasurisë së konfiskuar në aktakuzë, etj.

AAPSK ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore; Ndihton në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, sipas kërkesës së organeve kompetente; mundëson shitjen e

pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent, angazhon ekspert sipas nevojës për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar, administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik.

Gjykatat në bazë të KPPRK shqyrtojnë kërkesat e prokurorisë për urdhërimin e sekuestrimit të përkohshëm dhe vendosin lidhur me ato kërkesa, shqyrtojnë kërkesat për lëshimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë që është objekt i sekuestrimit sipas urdhrit dhe vendosin për masat e përkohshme konkrete të sigurisë, shqyrton kërkesat e prokurorisë për lëshimin e urdhrit ndalues që konsiston në ngrirjen e aseteve. Vendos përfundimisht lidhur me konfiskimin e pasurisë ku sëbashku me aktgjykim urdhëron edhe konfiskimin. Poashtu gjykata në bazë të LKZKPPVP vendos për konfiskimin e pasurisë ndaj personit që ka vdekur edhe pse nuk është gjykuar për veprën penale që dyshohet, vendos për konfiskimin e pasurisë për personin që është dënuar me aktgjykim për veprën penale nga Kapitulli XV, XXIII, XXIV, XXV ose XXX IV e që në procedurë nuk është vendosur lidhur me konfiskimin e pasurisë.

Pavarësisht përpjekjeve të organeve të ndjekjes por edhe rezultateve që janë prezentuar gjatë viteve 2013 dhe 2014, megjithatë vërehet se ka nevojë që Kosova të avancoj në këtë drejtim duke adoptuar praktika të reja sikurse është ligji që lejon konfiskimin e pasurisë edhe pa aktgjykim dënues ngase Kosova deri më tani ka bërë shumë pak në këtë drejtim dhe për këtë flasin shumat e konfiskimeve që kanë ndodhur sikurse edhe raportet e organizatave ndërkombëtare që theksojnë se Kosova deri më tani ka bërë shumë pak në këtë drejtim. Kjo është pjesërisht edhe si pasojë e ligjit aktual që nuk lejon konfiskimin e pasurisë pa aktgjykim dënues por në vend të kësaj kërkohet që paraprakisht të kemi një aktgjykim dënues, edhe atë për disa vepra penale, të sqaruara si më lartë.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të organeve të ndjekjes, Kosova më 2013 ka aprovuar KPRK-në e re dhe KPPRK-në e re që i kanë vënë theks konfiskimin duke paraparë dispozita dhe kapituj që nuk kanë qenë të njohur në ligjet e vjetra. Poashtu më 2013, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar LKZKPPVP-në që parasheh edhe disa forma të tjera kur mund të bëhet konfiskimi i pasurisë së paligjshme dhe këto në një formë kanë ndikuar që viti 2014 të jetë vit kur Kosova ka pasur më tepër sekuestrime dhe konfiskime në raport me vitin 2013. Kjo është kështu ngase përderisa në vitin 2013 ka pasur disa mijëra konfiskime dhe vetëm 2.500.000 € sekuestrime, në vitin 2014 ka pasur rreth 500.000 – 1.000.000 € si dhe rreth 31.000.000 € sekuestrime. Kjo provon se është bërë një hap në drejtimin e duhur por megjithatë ka nevojë që legjislacioni të avancoj akoma më tepër

në këtë drejtim dhe ligji që lejon konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme pa aktgjykim dënues do të rriste ndjeshëm luftën e organeve të ndjekjes në këtë drejtim.

Organet e ndjekjes kanë bërë përpjekje në luftimin e krimit ekonomik por edhe format tjera me përfitime pasurore deri në një masë të caktuar por që të kemi rezultate më të theksuara në këtë fushë nevojitet amandamentimi i ligjit apo aprovimi i një ligji të ri që do të lehtësonte më tepër konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme.

Ligjet dhe aktet nënligjore

KPRK, KPPRK, LKZKPPVP, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit 03/L-196, Ligji nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Kodi Doganor dhe i Akcizave, Ligji për Administratën tatimore dhe Procedurat, Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, konventat ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, etj.

Nenet 62, 96, 97, 99 të KPRK ndërlidhen me këtë çështje. Neni 96 përcakton bazat e konfiskimit të dobisë pasurore, neni 97 përcakton kushtet dhe mënyrën e konfiskimit të dobisë pasurore, neni 99 ka të bëjë me konfiskimin e dobisë pasurore nga personat juridik kurse neni 62 ndërlidhet me konfiskimin si dënim plotësues.

KPPRK në nenin 105 përcakton kontrollin dhe sekuestrimin e përkohshëm, neni 112 ka të bëjë me sekuestrimin e përkohshëm, neni 264 për ngrirjen, neni 265 për urdhërin ndalues, neni 267 për konfiskimin e përkohshëm, neni 268 për kërkesat për masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, neni 269 për masat e përkohshme, neni 273 për urdhërin për masat e përkohshme, neni 275 për provat e nevojshme për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, neni 276 për përcaktimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, neni 277 për llogaritjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, neni 278 për dobinë pasurore nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë, neni 281 për pasurinë që rezulton nga veprimet korruptive, neni 282 për pasurinë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, neni 283 provat që kërkohen për konfiskimin e pasurisë së përdorur në kryerjen e veprës penale, neni 284 për urdhërin e arsyetuar për konfiskimin e pasurisë, neni 487.3 për ekzekutimin e aktgjykimit lidhur me shpenzimet e procedurës penale, konfiskimin e dobisë pasurore dhe kërkesën pasurore juridike.

LKZKPPVP në nenin 6 përcakton kushtet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal, neni 7 përcakton kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit i cili ka vdekur dhe neni 8 përcakton kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit që gjendet në arrati.

Ligjet aktuale nuk parashohin mundësinë e konfiskimit të dobisë pasurore pa aktgjykim dënues dhe njëkohësisht ligjet aktuale nuk parashohin dispozita të qartë për konfiskimin nga palët e treta. Mangësitë më tutje kanë të bëjnë me faktin se barra e të provuarit qëndron nga ana e prokurorit dhe kjo paraqet vështirësi shtesë në përgatitjen e rasteve.

LKZKPPVP është aprovuar në fillim të vitit 2013 por deri më tani është aplikuar në masë të vogël nga ana e prokurorëve dhe kjo ka të bëjë kryesisht me faktin se barra e të provuarit me këtë ligj aktual bie kryesisht mbi prokurorinë kurse në anën tjetër të pandehurit kanë qenë në një pozitë shumë më të mirë ngase edhe përkundër asaj se kanë krijuar pasuri të pajustificueshme, nga ata nuk është kërkuar që të arsyetojnë burimin e të ardhurave të tyre.

Programi aktual

Ekziston dokumenti i aprovuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i titulluar, “*Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jofromale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014 – 2018*”. Përgjegjës për këtë program është Ministria e Financave.

Ministria e Financave mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Kjo detyrë është e ndërlidhur me përgjegjësitë tjera ligjore të saj.

Ministria e Financave kryeson Grupin Punues Qeveritar, Sekretariatit dhe Grupin Punues Teknik të cilat janë themeluar për Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018.

Grupi Punues Qeveritar është përgjegjëse për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Ajo do të paraqesë propozimet për miratimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Grupi Punues Qeveritar kryesohet nga Ministri i Financave. Anëtarët e tjerë janë: Ministri i Drejtësisë; Ministri i Punëve të Brendshme; Ministri i Tregtisë dhe Industrisë; Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale; Drejtori i Policisë së Kosovës; Drejtori i Doganës së Kosovës; Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës; Kryeprokurori i Shtetit; Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës; Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës; Drejtori i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit dhe Drejtori i Njesisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.

Shpenzimet aktuale

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	AAPSK- 409,195.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 62,146.00 €	AAPSK- 369,407.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 69,079.00 €	AAPSK- 369,407.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 69,079.00 €
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	n/a		
Financimi nga donatorët			
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave			

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Identifikimi i pronave të të dyshuarve, vështirësitë me regjistrimin e pronave të paluajtshme në Agjencinë e Kadastrit të Kosovës, mungesa e databazave lidhur me pronat, pagesat e bazuara në para të gatshme, mungesa e përvojës dhe specializimeve në polici, prokurori, gjykata dhe institucione tjera - mungesa e resurseve njerëzore, përfshirë kadrove profesionale, bashkëpunëtorëve të pamjaftueshëm etj., ekonomia joformale, etj.

Ngase barrën e të provuarit edhe në këtë moment e vendos në masë të madhe tek organi i ndjekjes duke vështirësuar punë ne tyre në një efikasitet më të lartë.

Përvoja në shtetet tjera

Një numër i caktuar i shteteve si Shqipëria, mali i ZI, Italia, Anglia, Irlanda etj. Kanë pasur probleme të ngjashme. Këto shtete tashmë kanë avancuar në aprovimin e ligjeve të reja dhe kanë tashmë në përdorim ligjin që lejon konfiskimin e pasurisë edhe pa aktgjykim dënues, një ligj i cili po propozohet nga ky grup punues.

Ashtu sikurse edhe në këto vende, por edhe shumë vende tjera në rajon dhe botë, meqenëse konsiderohet se janë së paku 34 shtete që kanë një legjislacion të ngjashëm me atë të Ligjit Anti Mafia, mendojmë se rritja e efikasitetit në ndjekjen e kryesve të veprave penale të krimeve ekonomike, korrupsionit por edhe e krimeve tjera që gjenerojnë përfitime pasurore është parakusht që të kemi ligjin që lejon konfiskimin edhe pa aktgjykim dënues dhe që zhvendos barrën e të provuarit nga prokurori tek i pandehuri.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi i këtij koncept dokumenti është rritja e përpjekjeve për të dekurajuar në maksimum korrupsionin përmes sekuestrimit apo konfiskimit të të gjitha pasurive të paligjshme që burojnë nga veprat penale të korrupsionit por edhe veprave tjera që gjenerojnë përfitime pasurore.

Objektivat

1. Rritja e efikasitetit në përdorimin e urdhërave të ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit dhe që buxheti të vendit ti derdhet një shumë më e madhe e të hollave nga konfiskimet përfundimtare por edhe luftimi i ekonomisë joformale.
2. Duhet të ndryshohet ligji aktual duke lejuar konfiskimin e pasurisë edhe pa aktgjykim dënues.
3. E sqaruar si më lartë.
4. Statistikat e prodhuara nga ana e KKLKE-së dhe AAPSK-së do të mundësojnë analizimin e rezultateve në afatet të caktuara nga viti në vit.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Gjendja aktuale e përcaktuar sipas ligjeve të cekura më lartë, eventualisht me ndryshimin e qasjes së organeve kompetente për zbatimin e këtyre ligjeve konsiderohet se është e pamjaftueshme dhe rrjedhimisht e pamundshme për luftimin me sukses të konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Nëse vazhdohet me politikën/ligjet ekzistuese, atëherë edhe rritja e efikasitetit në konfiskimin e pasurive të kundërligjshme do të vihej në pikëpyetje.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika ekzistuese mund të ndryshohet vetëm me aprovimin e një politike/ ligji të ri që lejon konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme edhe pa aktgjykim dënues.

Përmes këtij Ligji synohet që të lejohet konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme edhe pa aktgjykim dënues, edhe atë për pronën e paluajtshme, pronën e luajtshme në një vlerë të caktuar monetare (p.sh. asete që vlejnë 5.000 euro ose më tepër), para në të gatshme ose që mbahen në institucione financiare, aksione ose prona të ndryshme, asete tjera nga të cilat mund të financohen aktivitete kriminale. Konfiskimi i aseteve do të bëhet i mundshëm vetëm për pasurinë e krijuar nga data 1 qershor 1999 e deri në ditën e tashme.

Kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, pavarësisht vendndodhjes së aseteve. Provat e siguruar përgjatë një procedure penale mund të përdoren si dëshmi në mbështetje të rastit si *prima facie* ose kundërshtimi i rastit në procedurën e konfiskimit nën këtë ligj. Poashtu dëshmitë gjatë procedurës së konfiskimit mund të përdoren si dëshmi në secilën procedurë penale. Asnjë procedurë konfiskimi nën këtë kapitull nuk do të iniciohet nën bazën e njëjtë faktike nën një procedurë penale e cila ka rezultuar me një aktgjykim lirues. Procedura e konfiskimit do të mund të iniciohet nën dyshimin e arsyeshëm se asetet e përshkruara janë financiar ose përbëjnë aktivitet që do të ishte vepër penale nën kapitujt XIV, XV, XXIII, XXIV, XXV dhe XXXIV të KPRK-së. Gjykata Themelore e Prishtinës, DKR-ka do të caktoj një gjykatës që do të mbikëqyr mbledhjen e provave dhe gjykimin.

Përgjegjëse sipas kësaj politike synohet të jenë Policia e Kosovës, prokuroria, gjykatat dhe institucionet tjera zbatuese të ligjit.

Mund të paraqitet nevoja për më tepër trajnim të hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit

Opsion i tretë që do të ishte përmes ndryshimit dhe plotësimit të LKZKPPVP-së.

Përgjegjës do të jenë PK, prokuroritë, gjykatat dhe institucionet tjera zbatuese të ligjit.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Staus quo	Ligji i ri	Ndryshim plotësimi i ligjit për LKZK-në
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar			
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët			
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit			
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet			
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat			
Fushatat e edukimit dhe komunikimit			
Udhëzimet dhe kodet			
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni		Sa më parë	

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Megjithëse nuk është e mundur që të vlerësohen me siguri përfitimet, pasojat negative dhe kostoja e opsioneve, përmes analizës së informatave në dispozicion dhe konsultimit me grupet e prekura, është e mundur që të krijohet pasqyra më e mirë e saktë.

Përfitimet

1. **Përfitimet e opsionit 1 (*status quo*).** Opsioni i parë nuk duket se ka të ngjarë të rrisë përfitimet e të ardhurave nga konfiskimet e pasurisë së krijuar në mënyrë të kundërligjshme e kjo për shkak të arsyeve të dhëna si më lartë, në disa raste.
2. **Përfitimet e opsionit 2.** Aprovimi i një politike të re/ligjit të ri do të shpie deri tek rritja e efikasitetit të organeve të drejtësisë në konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme ngase do të ketë mundësi që të bëhet konfiskimi edhe në ato raste kur nuk ka aktgjykim dënues. Në të njëjtën kohë do të ndihmonte vendin edhe në integritet evropiane ngase shuma e konfiskimeve mund të rritet me ligjin e ri, e që është një kërkesë që del nga përmbushja e agjendës evropiane.
3. **Përfitimet e opsionit 3.** Përfitimet nga ky opsion do të ishin më të pjesshme ngase edhe mundësia për të parashtuar kërkesa për konfiskime do të ishte më e kufizuar.

Pasojat negative

1. **Pasojat negative të opsionit 1 (*status quo*).** Ndikim negativ do të kishte në radhë të parë buxheti i vendit sepse do të mbetj pa të ardhurat që realisht do të duheshin të derdhen në atë buxhet si pasojë e konfiskimeve që do të kryheshin. Lidhur me konfiskimin nga palët e treta korniza aktuale ligjore e Kosovës, në veçanti në LKZKPPVP, nuk është në përputhje të plotë me Direktivën 2014/42/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 3 prill 2014 dhe jo koherente me KPRK.
2. Eventualisht mund të ketë kritika më të mëdha rreth shkeljes së mundshme të drejtave të njeriut ngase një pjesë e madhe e barrës së të provuarit do të zhvendoset tek i pandehuri.

3. Pasojat negative të opsionit 3 janë se nuk do të arrihet qëllimi që të kemi një legjislacion koherent me *Acquis* të BE-së, dhe do të mund të pritëshin rezultate të pjesshme.

Kosto

Të gjitha ministritë duhet të respektojnë udhëzimet përkatëse të nxjerra nga Ministria e Financave, në pajtim me nenin 31 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1	AAPSK- 369,407.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 69,079.00 €	AAPSK- 369,407.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 69,079.00 €	AAPSK- 369,407.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 69,079.00 €	AAPSK- 369,407.00 €, Njësia kundër Krimeve Ekonomike - 69,079.00 €
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve		AAPSK- 169,000.00 € KKLKE - 50,000.00	AAPSK- 169,000.00 € KKLKE - 50,000.00	AAPSK- 169,000.00 € KKLKE - 50,000.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				

Financimi i pritur nga donatorët				
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve		AAPSK- 169,000.00 € KKLKE - 50,000.00	AAPSK- 169,000.00 € KKLKE - 50,000.00	AAPSK- 169,000.00 € KKLKE - 50,000.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				

Për të dhënat në këtë tabelë është përgatitur edhe formulari i Vlerësimit të Ndikimit Financiar.

Kapitulli 7: Konsultimi

Gjatë hartimit të këtij koncept dokumenti kanë marrë pjesë përfaqësues të KGJK-së, respektivisht gjykatave, KPK-së, AAPSK, MD, PK si dhe Zyra e Kryeministrit.

Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë, në universitete ose agjenci)

Gjatë hartimit të këtij koncepti është konsultuar eksperti Britanik Cedric Woodhall, i cili ka rekomanduar ligjin e ri anti mafia, ndërsa eksperti gjerman Stefan Trunk gjerman ka rekomanduar plotësim ndryshimin e Kodit Penal, plotësim ndryshimin e Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, dhe poashtu ka sugjeruar rishikimin e ardhshëm edhe të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht nenin 278.

Konsultimi me ministritë e tjera dhe me akterët – organizatat ose individët me publikun dhe shoqërinë civile që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë do të bëhet me rastin e dërgimit të Koncept Dokumenti në konsultime paraprake sipas Nenit 7 (3)

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

1. Opsioni 1. Nëse vazhdohet më të njëjtin ligj, mund të tentohet përmirësimi i vogël në aspekt të efikasitetit në konfiskimin e pasurisë së paligjshme, por që e gjithë kjo mbetet me një pikëpyetje dhe të panjohura ngase mundësitë për përmirësim do të jenë të kufizuara.
2. Opsionit 2. Aprovimi i një ligji të ri ka të ngjarë që të risë ndjeshëm shumën e konfiskimeve përfundimtare ngase barra e të provuarit në masë të madhe do të kalojë në anën e të pandehurit dhe puna e organeve të ndjekjes do të lehtësohet në masë shumë më të madhe. Synimi i këtij opsioni është rritja e përpjekjeve për të dekurajuar në maksimum korrupsionin, nëpërmjet sekuestrimit apo konfiskimit të të gjitha pasurive të paligjshme, që burojnë nga veprat penale. Me miratimin e këtij ligji kemi mundësi që tu japim organeve ndjekëse dhe atyre gjyqësore, një instrument që t'i luftojnë krimin duke sekuestruar dhe konfiskuar pasurinë, ashtu do të luftohet korrupsioni dhe do të përçohet mesazh i duhur, se krimi nuk shpaguehet dhe se heret apo vonë të gjitha pasuritë e paligjshme do të konfiskohen.
3. Opsionit 3. Edhe me këtë opsion ka mundësi të rritjes së efikasitetit dhe rritjes së shumës së konfiskimeve por që për shkaqe praktike, apo kalimit nga një ligj në ligjin tjetër, konsiderojmë se aprovimi i një ligji të ri do të sensibilizonte shumë më tepër komunitetin e njerëzve profesionistë, dhe me këtë edhe një punë më efektive në këtë lëmi.

Opsioni i dytë ka më shumti mundësi të arrijë synimet e parashtruara në objektivin e përcaktuar në Pjesën e 3.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Aprovimi i një ligjit të ri, në pajtim me opsionin e dytë që do të mundësonte konfiskimin e pasurive të paligjshme edhe pa aktgjykim dënues, dhe nëse qeveria e vendit pajtohet me hartimin e këtij koncept dokumenti, MD-ja do të hartojë dhe dorëzojë për miratim në qeveri Projektligjin mbi Konfiskimin.

Aprovimi i këtij ligji duhet të bëhet fillimisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës e më pas do të dërgohet tek Kuvendi i Kosovës për aprovim final

Synohet që kjo politikë të filloj së aplikuari mundësisht në fillim të vitit 2016, me koston e paraparë si më lartë.

Pas miratimit të këtij koncept dokumenti pritët që deri në fund të vitit 2015 MD të dorëzojë një projektligj për këtë çështje.

Kapitulli 10: Komunikimi

Deri më tani është bërë një komunikatë, ndërsa konsiderohet se për shkak të rëndësisë shumë të madhe që ka ky projektligj, nëse do të hartohet në të ardhmen, është e dëshirueshme që të ketë një komunikim adekuat me publikun, ministria do të komunikojë me të gjithë aktorët relevant që janë të prekur. Komunikimi do të bëhet në forma të ndryshme, dukë përfshirë komunikimin me shkrim, konsultime përmes tryezave të rrumbullakëta, takimeve të ndryshme etj.